



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 56, datë 09/12/2004

**“MBI TRANSFERIM FONDESH
BRENDA BUXHETIT TË QENDRËS EKONOMIKE TË ZHVILLIMIT DHE
EDUKIMIT TË FËMIJËVE PËR VITIN 2004”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19/9 dhe neni 32/dh, ligji Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal” neni 18 dhe 22, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2003 dhe detajimin e buxhetit për vitin 2004”, bazuar në kërkesën e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Nr.1074, dt.12/11/2004 dhe në relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë pakësimin e fondeve nga të ardhurat e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve në artikullin 600 (paga) për shumën 4.650.000 lekë si dhe në artikullin 601 (sigurime shoqërore) për shumën 2.720.000 lekë duke i transferuar në artikullin 602 (shpenzime operative) për shumën totale 7.370.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI